

VENDIM
Nr.165, datë 28.3.2007

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR NEVOJAT E VETA, TË MJEDISEVE, PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËTIJ INSTITUCIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të mjediseve të ndërtesës me numër pasurie 2/100, të volumit 11, faqe 182, me përshkrimin “Klubi i Lidhjes”, sipas hartës treguese të pasurisë dhe kartelës së pasurisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.271, datë 10.6.1999 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, të mjediseve të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Qendrës Kulturore Franceze”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të marrë të gjitha masat, për mbylljen e të gjitha kontratave të qirave dhe nënqirave për përdorimin e të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



